



Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2024

FTESË PËR OFERTË

"PËR SISTEMIN DINAMIK TË BILETAVE TË TRANSPORTIT AJROR NDËRKOMBËTAR".

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail hasar@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a, do të zhvillojë procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, me objekt: **"Blerje 3 (tre) bileta avioni"**, me destinacion Pragën në datën 11 shtator.

Data e zhvillimit do të jetë 09.09.2024 (jo më pak se 3 orë nga momenti i publikimit), ora 10:30 në adresën: www.app.gov.al.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

Specifikimet teknike:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Bileta avioni Tiranë-Pragë-Tiranë	Copë	3

Udhëtimi i përfaqësuesve të KESH sh.a që dërgohet me shërbim jashtë vendit do të realizohet me anë të transportit ajror, (avion), sipas detajeve më poshtë:

- ✚ Nisja do të realizohet me datë 11 shtator 2024 paradite, me avion, në intinerarin Tiranë-Pragë.
- ✚ Kthimi nga Praga në drejtim të Tiranës do të realizohet me datë 14 shtator paradite
- ✚ Fluturimi të jetë linjë direkte;
- ✚ Klasi ekonomik (economy flex);
- ✚ Bagazhi i përfshirë;

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, dokumentet si më poshtë:

- 1) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar;
- 2) Formularin e ofertës ekonomike.
- 3) Të jetë i licensuar nga IATA për aktivitetin profesional duke paraqitur çertifikatën përkatëse, e vlefshme për vitin në vazhdim.
- 4) Operatori Ekonomik duhet të ketë të parashikuar në objektin e veprimtarisë së tij fushën e objektit të prokurimit;

- 5) Një dokument që vërteton se subjekti juaj ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore;
- 6) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të faturave;
- 7) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara deri në muajin e fundit të energjisë elektrike;

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë dokumentacionin fizik pranë Autoritetit Kontraktor brenda 24 orëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit.

Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e itinerarit.

OE duhet të garantojë përballimin e çdo pasojë të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.

Afati i dorëzimit të dokumenteve do të jetë jo me pak se 2 (dy) orë nga shpallja e njoftimit të fituesit. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues pranë KESH sh.a. Në të kundërt, do të bëhet kalimi te ofertuesi i radhës i kualifikuar në SPE, e kështu me radhë, deri në ofertuesin e fundit të mbetur në klasifikim.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

**PËR TITULLARIN E AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR**

Joana BUSHI